

Informim javor për median
(17 shtator 2021; 15:00)
Dhomat & Zyra Administrative

Mirë se vini në informimin e parë javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës ku do t'ju ofrojmë rregullisht informacion të përditësuar lidhur me proceset dhe aktivitetet e Gjykatës.

Këto informime për median synojmë t'i organizojmë të premteve në orën 15:00.

Aktualisht, pjesëmarrja do të jetë vetëm nëpërmjet Zoom-it. Në fund të informimit, gazetarët do të kenë mundësi të parashtrojnë pyetje dhe ne do të përpiqemi t'u përgjigjemi pyetjeve sa më mirë që të mundemi. Në qoftë se nuk mundemi t'i përgjigjemi një pyetjeje menjëherë, përgjigjen do t'jua kthejmë me shkrim.

Kjo ishte një javë me shumë angazhime dhe me rëndësi për Dhomat e Specializuara të Kosovës, gjatë së cilës u mbajtën dy seanca publike për dy çështje të ndryshme.

Seanca e parë u mbajt të martën, në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit* dhe të bashkakuzuarve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti seancë për konferencën mbi ecurinë e çështjes. Një seancë e tillë mbahet rregullisht për t'i mundësuar Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes që t'i bëjnë të njohur Gjykatësit të Procedurës Paraprake ndonjë çështje, nëse kanë, dhe t'i ofrojnë informacion të përditësuar lidhur me stadin aktual të përgatitjeve të tyre për gjykimin.

Të martën, gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes në lëndën *Thaçi dhe të tjerët* u diskutuan një sërë temash, ndër to, edhe data kur Prokurori i Specializuar duhet të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake lidhur me listën e dëshmitarëve që ai synon të thërrasë gjatë procesit gjyqësor, si dhe procesi i quajtur "nxjerrja e materialit".

Nxjerrja e materialit është detyrim për Prokurorin e Specializuar për t'i ofruar Mbrojtjes provat në të cilat synon të mbështet për të provuar argumentet e tij.

Palët gjithashtu i dhanë Gjykatësit të Procedurës Paraprake informacion të përditësuar lidhur me statusin e hetimeve të tyre dhe Mbrojtja pyeti lidhur me ecurinë e përkthimeve të vendimeve të rëndësishme.

Sa u përket përkthimeve, Zyra Administrative konfirmoi se tanimë janë përkthyer të gjitha dokumentet që kërkohen të përkthehen në bazë të Ligjit dhe Rregullores. Palët gjithashtu mund të kërkojnë që parashtrimeve të caktuara t'u jepet prioritet në përkthim.

Të mërkurën, fillimi i gjykimit të parë në çështjen kundër zotit Salih Mustafa, shënoi një arritje të rëndësishme për DHSK-në.

Në këtë ditë, Prokurori i Specializuar dhe avokatja që përfaqëson nëntë viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje bënë ato që quhen "deklarata hyrëse". Gjatë deklaratës së tij hyrëse, Prokurori i Specializuar paraqiti çështjen e tij dhe shpjegoi se çfarë synon të provojë në fund të gjykimit. Gjatë deklaratës së saj hyrëse, mbrojtësja e viktimave foli për pikëpamjet e viktimave.

Gjykatësit e Trupit Gjykues në këtë çështje më herët kishin vendosur se Prokurori i Specializuar do të ketë 87 orë për të paraqitur provat e veta. Prokurori i Specializuar tregoi se gjatë kësaj kohe, synon të thërrasë 16 dëshmitarë, nga të cilët 15 do të dëshmojnë duke qenë të pranishëm.

Mbrojtësi i z. Mustafa tha se ai planifikon të bëjë deklaratën e tij hyrëse pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar.

Gjykimi i z. Mustafa do të vazhdojë të hënën e ardhshme, në orën 9:30 me dhënien e dëshmisë së dëshmitarit të parë në këtë çështje. Seancat gjyqësore në këtë çështje do të vazhdojnë gjatë javës së ardhshme dhe në muajt shtator dhe tetor.

Më shumë informacione për orarin e seancave mund të gjeni në kalendarin e Gjykatës në faqen tonë të internetit. Seancat publike transmetohen me vonesë prej 45 minutash, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Të gjitha seancat publike do të mund të shihen në kanalin tonë në YouTube në shqipe, serbishte dhe anglishte, pas mbajtjes së këtyre seancave

Sa u përket vizitave të paraburgosurit, kemi kënaqësinë t'ju informojmë se, në bazë të këshillave mjekësore, që nga 6 shtatori vizitat personale nuk janë më vetëm me të afërmit e ngushtë.

Njëri prej gazetarëve kërkoi më shumë informacion mbi dëshmitarin i cili do të dëshmojë javën e ardhshme në çështjen Salih Mustafa dhe zëdhënësi u përgjigj se informacioni i vetëm që mund të jepte ishte se ai është dëshmitar i prokurorisë. Një gazetar tjetër bëri gjithashtu një sugjerim në lidhje me orarin e informimeve javore në të ardhmen.